



Në bazë të nenit 12, paragrafi 2, shkronja (d), lidhur me nenin 14, dhe 17, të Ligjit Nr-03/L-040, për Vetëqeverisjen Lokale, publikuar në “Gazetën zyrtare të Republikës së Kosovës, Nr. 28/2008”, e në mbështetje të nenit 6, paragrafi 1, pika 1.2, lidhur me nenin 8, paragrafi 1, pika 1.2, e konform nenit 19, paragrafi 3, pika 3.1 dhe 3.2 të Ligjit Nr-06/L-092, për dhënien në shfrytëzim dhe këmbimin e pronës së paluajtshme të Komunës, publikuar në “Gazetën zyrtare të Republikës së Kosovës, Nr. 10/2019” dhe neneve 15, 29, pika 2, të Statutit të Komunës së Suharekës, 01-Nr-8336, i datës 04.11.2008, Kuvendi i Komunës në Suharekë, në mbledhjen e mbajtur me datë, 29.01.2021, miraton këtë:

V E N D I M

Neni 1

1. Me këtë vendim personit fizik dhe juridik të cekur më poshtë; **I jepet** në shfrytëzim afatgjatë për **99, (nëntëdhjetë e nëntë)** vite, prona e paluajtshme, pasuri shoqërore në emër të Komunës së Suharekës, në **“Zona industriale”** në Shirokë, **për ushtrim të veprimtarisë afariste**, sipas rekomandimit 01-Nr-463-1853 të datës 11.01.2021, të komisionit për zbatimin e procedurave dhe vlerësimin e ofertave për dhënien në shfrytëzim afatshkurtër dhe afatgjatë të pronës së paluajtshme të Komunës.

1.1 Firmës **“Logi Group” SH.P.K** me seli në fshatin Lubizhdë Komuna e Prizrenit, të cilën e përfaqëson **Hajrush KUKAJ & N.N.T “Etniki”** me seli në fshatin Samadrexhë të cilën e përfaqëson **Tahir BUGARI, i jepet;** parcela **Nr-2785/12**, me sipërfaqe të përgjithshëm **S=8000m²**, me destinim sipas planit rregullativ **“Depo ushqimore”**.

Neni 2

Afati për shfrytëzimin e pronës së paluajtshme fillon të rrjedh nga data, **29.01.2021** dhe përfundon afati më datën, **28.01.2120**, pas mbarimit të këtij afati ose ndërprerjes së parakohshme të kontratës e drejta e shfrytëzimit i kthehet Komunës së Suharekës si titullar faktik dhe juridik.

Neni 3

3.1 **Obligohet;** Kryetari i Komunës që me **personat fizik dhe juridik përfitues të pronës së paluajtshme të Komunës**, të lidh kontratë me të cilën i përcaktojnë të drejtat dhe obligimet e palëve kontraktuese.

3.2. **Obligohen;** përfituesit e pronave të paluajtshme të Komunës, konkretisht personat fizikë dhe juridikë të cekur në neni 1, të këtij vendimi, që në afat prej 10, (dhjetë) dite nga data e miratimit të këtij vendimi të sjellin garancioni bankar ose sigurimin nga kompanit e sigurimeve të licencuar në Republikën e Kosovës dhe atë 10% të vlerës së propozuar investive.

3.3 Nëse personat e cekur në paragrafin 2, të nenit 3, të këtij vendimi nuk e sjellin dokumentacionin e kërkuar në afatin ligjor, konsiderohet se ka hequr dorë nga shfrytëzimi i pronës së paluajtshme.



Neni 4

4.1 Obligohen shfrytëzuesit e cekur në nenin 1, të këtij vendimi, që pronën e paluajtshme të cekur në nenin 1, të këtë vendim, ta shfrytëzojnë me mirëbesim si nikoqir i mirë, që mos t'ia humbë vlerën e saj.

4.2 Prona e paluajtshme në fjalë nuk e ndërron titullarin juridik, pronarë i saj mbetet Kuvendi Komunal i Suharekës dhe si e tillë ajo nuk mund t'i epet personit të tretë në shfrytëzim nga ana e shfrytëzuesit, nuk mund të tjetërsohet, nuk mund të jetë objekt i ndonjë barre tatimore apo çfarëdo ngarkese tjetër mbi këtë pronë.

Neni 5

Pas miratimit nga ana e Kuvendit të Komunës në Suharekë, ky vendim hyn në fuqi 15, ditë pas dërgimit në autoritetin mbikëqyrës, në kuptim të nenit 81, të Ligjit mbi vetëqeverisjen lokale, Nr-03/L-040, "Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës, Nr-28/2008" dhe nenit 8, lidhur me nenin 9, të Rregullores, Nr-10/2019, për procedurat e hartimit dhe publikimin e akteve të Komunave dhe pas shpalljes publike në tabelën e shpalljeve ose web-faqen zyrtare të Komunës.

KUVENDI I KOMUNËS NË SUHAREKË

01-Nr-016-7540
Më datë 29-01-2021



Kryesuesi i Kuvendit
[Signature]
Mr. ec Bexhet KUÇI

1. *[Signature]*
29.01.2021

2. *[Signature]*